

L I G J
Nr.8001, datë 22.9.1995

**PËR GENOCIDIN DHE KRIMET KUNDËR NJERËZIMIT KRYER NË SHQIPËRI GJATË
SUNDIMIT KOMUNIST PËR MOTIVE POLITIKE, IDEOLOGJIKE DHE FETARE**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, të neneve 1, 3, 6, 18 të ligjit nr.7692, datë 31.3.1993 “Për një shtojcë në dispozitat kryesore kushtetuese” dhe të neneve 67 dhe 74 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, duke dashur të përshpjetojë çështjet penale që lidhen me krime kundër njerëzimit për motive politike, ideologjike, klasore dhe fetare, organizuar dhe kryer nga shteti komunist në kundërshtim me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, nëpërmjet dhunës fizike e psikike, montimit, falsifikimit ose manipulimit të të dhënave, duke sjellë për pasojë vrasjen, burgosjen, internimin dhe dëbimin, si dhe rrënimin masiv të institucioneve dhe objekteve të kultit,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Organet e Prokurorisë, në përputhje me dispozitat penale dhe procedurale, ngarkohen të fillojnë menjëherë dhe me përparësi hetimin e veprimtarisë që lidhet me krimet kundër njerëzimit kryer në Shqipëri gjatë sundimit komunist për motive politike, ideologjike dhe fetare.

Neni 2

Autorët e veprimtarisë së parashikuar në nenin 1 të këtij ligji do të hetohen e gjykohen sipas Kodit të sotëm të Procedurës Penale.

Neni 3

Nuk mund të zgjidhen paskëtaj në organet qendrore dhe lokale të pushtetit dhe as të emërohen në administratën e lartë të Shtetit, në sistemin gjyqësor dhe në masmedia, deri në 31 dhjetor 2001 autorët, ideatorët dhe zbatuesit e krimeve të mësipërme, që kanë qënë deri më 31 mars 1991: ish-anëtarë të Byrosë Politike dhe të Komitetit Qendror të PPSH (dhe PKSH), ish-ministra dhe ish-deputetë të Kuvendit Popullor, ish-anëtarë të Këshillit Presidential, ish-kryetarët e Gjykatës së Lartë, ish-Prokurorët e Përgjithshëm, ish-sekretarë të parë të rretheve, ish-punonjës të Sigurimit të Shtetit, ish-bashkëpunëtorë të Sigurimit të Shtetit si dhe denoncuesit dëshmitarë në dëm të të pandehurve në proceset politike, me përjashtim të rasteve kur kanë vepruar kundër vijës zyrtare dhe janë larguar vetë në mënyrë publike.

Neni 4

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të përgatisë aktet ligjore dhe të miratojë aktet nënligjore deri më 15 dhjetor 1995.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.1221, datë 26.9.1995 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.

